



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

**Republika e Kosovës**
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Nr./Br.

942/19

Datë/Datum.

03.02.20

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PRISHTINË - PRIŠTINA

**PSH. nr. 942/19**

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të z. Blerim Dina - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE “Arhiko.ING O.P”- Prishtinë, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve detale” me nr. të prok: 613-19-1066-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Lipjan, më datën: 29.01.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Arhiko.ING O.P”-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve detale” me nr. të prok:613-19-1066-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Lipjan.

II. ANULOHET, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve detale” me nr. të prok:613-19-1066-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Lipjan dhe lënda kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues “Arhiko.ING O.P”-Prishtinë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI .Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE “Arhiko.ING O.P”- Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 20.12.2019 me nr. 942/ 19, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Hartimi i projekteve detale” me nr. të prok:613-19-1066-2-1-1, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Lipjan, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 59, 65, 66 dhe nenin 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 26.12.2019, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 16.01.2020, lidhur me pretendimin ankimor të OE-ankues sqaron si në vijim: Lidhur me Inxhinierin e Hidroteknikes, OE ankues lidhur me këtë kërkesë ka ofruar z. Skender Cakaj, i cili ka diplomuar në nivelin Magjistër me 24.07.2010. Me gjithë këtë në bashkangjitur me ankesën nr. 942/19 OE ka ofruar diplomën e z. Skender Cakaj nga fakulteti Ndërtimtarisë drejtimi Hidroteknikë me titull Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë të datës 24.12.1990, me çka vlerësojmë se plotëson kërkesën e AK-së për “inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi Hidroteknik”. Provë: Diploma e z. Skender Cakaj.

Lidhur me inxhinierin e Elektroteknikës, njëjtë si në rastin më lart, OE me rastin e ofertimit ka ofruar diplomën e datës 04 Korrik 2011 ndërsa bashkangjitur me ankesën ka ofruar diplomën e z. Arben Ramadani të datës 08 Korrik 2019, mirëpo në të dyja këto diploma shënon se Arben Ramadani studimet i mbaroi me 31 mars 2006 dhe mori titullin Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës. Për të njëjtin person po ashtu është ofruar CV me të gjitha të dhënat e nevojshme lidhur me përvojën e tij dhe vlerësojmë se ky pretendim ankimorë është i bazuar.

Sa i përket pretendimit ankimorë lidhur me tërheqjen nga grupi i anëtarit të Grupit “PMN shpk”, pas kthimit të lëndës në rivlerësim, me 24.10.2019 kompania PMN shpk ka dërguar shkresë pranë AK-së përmes së cilës deklaroi se janë pjesë e grupit dhe se pajtohen që Arhiko të jetë lider i grupit. Me këtë konsiderojmë se grupi

i OE-ve ofertues në këtë rast është i njëjtë si në momentin e ofertimit/hapjes së ofertave, do thotë tani nuk ka ndryshim në përbërje të grupit.

Provë : Njoftimi i kompanisë “PMN shpk” i datës 24.10.2019.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues “Arhiko” të aprovohet si e bazuar, ndërsa të anulohet njoftimi i AK-së për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Autoriteti Kontraktues, me datë: 17.01.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik, me datë: 16.01.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 29.01.2020, pa praninë e palëve konform nenit 26.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se ankesa është parashtruar kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit.

Paneli shqyrtues konstaton se sa i përket pretendimit ankimor lidhur me kërkesën e AK-së për mundësitë teknike dhe profesionale pika 9. 1& 9. 2- kapaciteti teknik dhe profesional: “inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë drejtimi Hidroteknik” paneli shqyrtues konstaton se OE ankues ka ofruar diplomën e z. Skender Cakaj nga fakulteti Ndërtimtarisë drejtimi Hidroteknikë me titull Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë të datës 24.12.1990, dhe në këtë rast OE ka plotësuar kërkesën e AK-së.

Paneli shqyrtues po ashtu konstaton se është i qëndrueshëm pretendimi ankimor i OE ankues lidhur me

inxhinierin e Elektroteknikës, sipas kërkesës në pikën 9. 1 dhe 9. 2 të DT, pasi që OE në ofertën e tij ka ofruar diplomën e datës 04 Korrik 2011 ndërsa bashkangjitur me ankesën ka ofruar diplomën e z. Arben Ramadani të datës 08 Korrik 2019, mirëpo në të dyja këto diploma shënon se Arben Ramadani studimet i mbaroi me 31 mars 2006 dhe mori titullin Inxhinier i diplomuar i Elektroteknikës. Për të njëjtin person po ashtu është ofruar CV me të gjitha të dhënat e nevojshme lidhur me përvojën e tij.

Sa i përket pretendimit ankimorë për tërheqjen nga grupi i anëtarit të Grupit “PMN shpk”, pas kthimit të lëndës në rivlerësim, me datën 24.10.2019 kompania “PMN” shpk ka dërguar shkresë pranë AK-së përmes së cilës deklaroi se janë pjesë e grupit dhe se pajtohen që Arhiko të jetë lider i grupit. Me këtë paneli shqyrtues vlerëson se grupi i OE-ve ofertues në këtë rast është i njëjtë si në momentin e ofertimit/hapjes së ofertave, do thotë tani nuk ka ndryshim në përbërje të grupit.

Paneli shqyrtues, konstaton se AK- KK Lipjan ka anuluar aktivitetin e prokurimit në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së pasi që me rastin e anulimit të këtij aktiviteti të prokurimit, nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet për anulim sipas par 1, pika 1. 1 dhe po ashtu paneli shqyrtues konstaton se AK nuk ka bërë vlerësimin, analizimin dhe krahasimin sipas nenit 59 të LPP-së pasi që ka eliminuar OE ankues nga procedura e tenderimit pa u plotësuar kushtet ligjore për anulim, dhe duke pasur parasysh faktin që pretendimet ankimore të OE ankues janë të bazuara, paneli shqyrtues sqaron se AK me rastin e rivlerësimit të aktiviteti të prokurimit, duhet të ketë parasysh nenin 1 të LPP-së- Qëllimi i ligjit dhe po ashtu duhet të veprojë në harmoni me nenin 6 të po këtij ligji.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK- Kuvendi Komunal Lipjan
- 1x1 OE - “Arhiko.ING O.P”-Prishtinë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.

